



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-188/1

Në bazë të nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 9.4 të Rregullores me nr. 04/2022 e datës 31 gusht 2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore (amadamentuar me datë 17.05.2023), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën 16 tetor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet raporti i dorëzuar nga komisioni për rivlerësim të qirave, sipas paraqitjes së ndryshimeve të vlerave të qirave.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Menaxhmenti i Agjencisë lidhur me shqyrtimin e raportit për rivlerësim të vlerave të qirave për kontratat aktive që kanë mbetur pa u rivlerësuar dhe për kontratat e administrimit direkt që ju skadon afati brenda tetorit 2023 deri në qershor 2024 sipas kërkesës paraprahe të Bordit në mbledhjet e kaluara me qëllim të rritjes së vlerës të inkasimit të mjeteve nga qiradhënia.

Ky vendim është marr duke u bazuar në arsyet se Komisioni ka përcaktuar zonat e hulumtimit, të cilat përfshijnë asetet nga lista e bashkangjitur duke i përkufizuar sipas rrugëve apo shesheve dhe do të kryej rreshtimin/grumbullimin e asetëve brenda zonës sipas kategorisë së asetit (lokale afariste, depo, zyre, toka bujqësore, toka komerciale etj.). Brenda zonës së hulumtimit dhe sipas kategorisë së asetit janë grumbulluar informacionet në lidhje me vlerën e tregut të qirasë duke respektuar parimet e përgjithshme të përshkruara në paragrafët më lartë. Komisioni ka marrë parasysh që pronat e ndërmarrjeve shoqërore janë ndërtesa/objekte të vjetra dhe kanë kosto të larta riparimesh që ndikojnë në ulje të të ardhurave për qiramarrësin, po ashtu gjatë viteve rritet edhe risku i marrjes së të ardhurave të vazhdueshme, që lidhet jo vetëm me mundësinë e mbetjes vakant përkohësisht të pronës, por edhe me ndjeshmërinë ndaj luhatjeve të tregut, problemet e vjetërsimit mund të bëjnë që prona të bëhet e papërshtatshme për t'u dhënë me qira dhe për pasojë kjo shoqërohet me pamundësinë e realizimit të të ardhurave.

Një tjetër faktor që është marrë parasysh është edhe shkalla e amortizimit që është funksion i moshës por edhe funksion i cilësive të ndërtesës, po ashtu të ardhurat që rezultojnë të merren nga prona në formë të qirasë varet nga karakteristikat e pronës. Sa më e lartë të jetë cilësia e ndërtesës aq më e lartë do të jetë dhe e ardhura që prona do të japë.


Duke marrë parasysh këto, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashtrojnë padi pranë Dhomës së Posaqme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 16 tetor 2023




Montor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

[illegible]

[illegible]

Nr.	ZR	NSH	Coal	Proca pe Ora	Adresa si probele pe Ora	Numarul la Emisiune pe Ora	Determinat	Relatiile e Afectii	Suprafata m²	Viteza Orasul	Data Emission	Data Preliminary	Viteza aqiqi	Cantitatea gasit pe (t/m³)	Cantitatea gasit pe (t/m³)	Diferenta m³ (t/m³) mas	Diferenta m³ (t/m³) mas	% e diferenta	% e diferenta	Suprafata (m²) *	Diferenta	Viteza e gasit	Viteza e gasit
71	MIT	Lux	MIT09-Q-3	Locali Alina NICOLAI	UL LOB RENA, b.b. Vireni	MIT09-Q-3	Locali Alina NICOLAI	Locali Alina NICOLAI	28.00	€ 100.00	1-Nov-16	30-Jun-24	3.81	€ 8.8	€ 4.07	€ (0.22)	€ (0.22)	-5%	-5%	105.82	€ 5.82	€ 1.72	€ 101.75
72	MIT	Lux	MIT09-Q-4	Locali Alina NICOLAI	UL LOB RENA, b.b. Vireni	MIT09-Q-4	Locali Alina NICOLAI	Locali Alina NICOLAI	67.00	€ 300.00	1-Aug-17	30-Jun-24	3.81	€ 4.07	€ 4.07	€ (0.46)	€ (0.46)	-17%	-17%	264.75	€ 44.75	€ 34.4	€ 303.44
73	MIT	Lux	MIT09-Q-21	Locali Alina NICOLAI	UL LOB RENA, b.b. Vireni	MIT09-Q-21	Locali Alina NICOLAI	Locali Alina NICOLAI	65.00	€ 150.00	1-Nov-16	30-Jun-24	3.81	€ 4.07	€ 4.07	€ (1.07)	€ (1.07)	-79%	-79%	264.75	€ 144.75	€ 14.4	€ 184.47
74	MIT	Lux	MIT09-Q-37	Locali Alina NICOLAI	UL LOB RENA, b.b. Vireni	MIT09-Q-37	Locali Alina NICOLAI	Locali Alina NICOLAI	45.00	€ 135.00	1-Jul-18	30-Jun-24	3.81	€ 4.07	€ 4.07	€ (1.23)	€ (1.23)	-45%	-45%	152.15	€ 45.15	€ 14.4	€ 144.46
75	MIT	Lux	MIT09-Q-50	Locali Alina NICOLAI	UL LOB RENA, b.b. Vireni	MIT09-Q-50	Locali Alina NICOLAI	Locali Alina NICOLAI	37.00	€ 105.00	1-Jul-18	30-Jun-24	3.81	€ 4.07	€ 4.07	€ (1.28)	€ (1.28)	-40%	-40%	113.01	€ 55.01	€ 10.50	€ 108.50
76	MIT	Lux	MIT09-Q-88	Locali Alina NICOLAI	UL LOB RENA, b.b. Vireni	MIT09-Q-88	Locali Alina NICOLAI	Locali Alina NICOLAI	43.00	€ 123.00	1-Jul-18	30-Jun-24	3.81	€ 4.07	€ 4.07	€ (0.96)	€ (0.96)	-52%	-52%	206.67	€ 79.67	€ 23.90	€ 277.80
77	MIT	Lux	MIT09-Q-15	Locali Alina NICOLAI	UL LOB RENA, b.b. Vireni	MIT09-Q-15	Locali Alina NICOLAI	Locali Alina NICOLAI	81.00	€ 250.00	6-Mar-15	30-Jun-24	3.81	€ 4.07	€ 4.07	€ (0.50)	€ (0.50)	-27%	-27%	2,146.86	€ 434.86	€ 132.40	€ 1,880.46
78	MIT	Kocovina	MIT09-Q-1	Locali Alina NICOLAI	UL LOB RENA, b.b. Vireni	MIT09-Q-1	Locali Alina NICOLAI	Locali Alina NICOLAI	438.99.00	€ 1,700.00	1-Nov-16	30-Jun-24	3.81	€ 4.07	€ 4.07	€ (13.80)	€ (13.80)	-277%	-277%	1,772.02	€ 1,300.02	€ 386.01	€ 690.01
79	MIT	Jugoslavica	MIT10-Q-5	Locali Alina NICOLAI	UL LOB RENA, b.b. Vireni	MIT10-Q-5	Locali Alina NICOLAI	Locali Alina NICOLAI	94.00	€ 470.00	1-Jul-17	30-Jun-24	3.81	€ 4.07	€ 4.07	€ (0.05)	€ (0.05)	-35%	-35%	375.40	€ 95.40	€ 28.82	€ 320.82
80	MIT	Muntenia	MIT11-Q-1	Locali Alina NICOLAI	UL LOB RENA, b.b. Vireni	MIT11-Q-1	Locali Alina NICOLAI	Locali Alina NICOLAI	699.00	€ 115.00	28-Aug-16	30-Jun-24	3.81	€ 4.07	€ 4.07	€ (0.03)	€ (0.03)	-21%	-21%	158.20	€ 24.20	€ 7.28	€ 122.28
81	MIT	Muntenia	MIT11-Q-2	Locali Alina NICOLAI	UL LOB RENA, b.b. Vireni	MIT11-Q-2	Locali Alina NICOLAI	Locali Alina NICOLAI	640.00	€ 118.00	1-Oct-17	30-Jun-24	3.81	€ 4.07	€ 4.07	€ (0.18)	€ (0.18)	-96%	-96%	1,286.00	€ 1,142.00	€ 346.60	€ 466.60
82	MIT	Muntenia	MIT11-Q-3	Locali Alina NICOLAI	UL LOB RENA, b.b. Vireni	MIT11-Q-3	Locali Alina NICOLAI	Locali Alina NICOLAI	500.00	€ 150.00	1-Sep-19	31-Aug-20	3.81	€ 4.07	€ 4.07	€ (0.20)	€ (0.20)	-35%	-35%	220.00	€ 50.00	€ 15.00	€ 155.00
83	MIT	Muntenia	MIT11-Q-4	Locali Alina NICOLAI	UL LOB RENA, b.b. Vireni	MIT11-Q-4	Locali Alina NICOLAI	Locali Alina NICOLAI	300.00	€ 100.00	1-Oct-20	30-Sep-23	3.81	€ 4.07	€ 4.07	€ (0.20)	€ (0.20)	-90%	-90%	80.00	€ 63.34	€ 19.00	€ 65.00
84	MIT	Muntenia	MIT11-Q-5	Locali Alina NICOLAI	UL LOB RENA, b.b. Vireni	MIT11-Q-5	Locali Alina NICOLAI	Locali Alina NICOLAI	2,400.00	€ 153.95	1-Oct-16	30-Sep-23	3.81	€ 4.07	€ 4.07	€ (0.28)	€ (0.28)	-220%	-220%	150.00	€ 110.00	€ 33.00	€ 87.00
85	MIT	Muntenia	MIT11-Q-6	Locali Alina NICOLAI	UL LOB RENA, b.b. Vireni	MIT11-Q-6	Locali Alina NICOLAI	Locali Alina NICOLAI	5,000.00	€ 83.34	2-Feb-16	30-Sep-23	3.81	€ 4.07	€ 4.07	€ (0.18)	€ (0.18)	-1,020%</					

Nr.	Tipul	Local	Proiect de Dis	Adresa si proiect de Dis	Intensitate de Dis	Clasament	Categorie si Anul	Suprafata m ²	Valoarea Dis	Data limit	Data pînă la care se va realiza proiectul	Valoarea Dis (m ²)	Cantitatea Dis (m ²)	Cantitatea Dis (m ²)	Diferenta Dis (m ²)	Diferenta Dis (m ²)	% a Dis Dis	% a Dis Dis	Suprafata Dis (m ²)	Diferenta	Valoarea Dis (m ²)	Valoarea Dis (m ²)
106	PRN	Zona 1000	PRN1000-1	Zona 1000, Anul Dis	Dis	PRN1000	PRN1000	172.00	€ 327.00	17-09-14	30-Sep-23	€ 1.00	€ 15.11	€ 15.11	€ 14.60	€ 14.60	-91%	-91%	€ 1.00	€ 1.00	€ 1.00	€ 1.00
107	PRN	Nuova Grand Hotel	PRN1000-1	Nuova Grand Hotel	Dis	PRN1000	PRN1000	64.17	€ 642.00	15-09-16	31-12-24	€ 10.00	€ 15.11	€ 15.11	€ 14.60	€ 14.60	-91%	-91%	€ 1.00	€ 1.00	€ 1.00	€ 1.00
108	PRN	Nuova Grand Hotel	PRN1000-1	Nuova Grand Hotel	Dis	PRN1000	PRN1000	918.84	€ 8114.00	15-09-16	31-12-24	€ 8.82	€ 9.47	€ 9.47	€ 9.47	€ 9.47	-7%	-7%	€ 8.82	€ 8.82	€ 8.82	€ 8.82
109	PRN	Nuova Grand Hotel	PRN1000-1	Nuova Grand Hotel	Dis	PRN1000	PRN1000	505.64	€ 4523.00	15-09-16	31-12-24	€ 9.14	€ 11.14	€ 11.14	€ 11.14	€ 11.14	-22%	-22%	€ 5.02	€ 5.02	€ 5.02	€ 5.02
110	PRN	Nuova Grand Hotel	PRN1000-1	Nuova Grand Hotel	Dis	PRN1000	PRN1000	728.22	€ 8080.00	15-09-16	31-12-24	€ 11.10	€ 11.14	€ 11.14	€ 11.14	€ 11.14	-9%	-9%	€ 9.06	€ 9.06	€ 9.06	€ 9.06
111	PRN	Nuova Grand Hotel	PRN1000-1	Nuova Grand Hotel	Dis	PRN1000	PRN1000	57.00	€ 550.00	15-09-16	31-12-24	€ 10.35	€ 11.14	€ 11.14	€ 11.14	€ 11.14	-8%	-8%	€ 5.04	€ 5.04	€ 5.04	€ 5.04
112	PRN	Nuova Grand Hotel	PRN1000-1	Nuova Grand Hotel	Dis	PRN1000	PRN1000	41.00	€ 200.00	15-09-16	31-12-24	€ 4.88	€ 11.14	€ 11.14	€ 11.14	€ 11.14	-128%	-128%	€ 4.88	€ 4.88	€ 4.88	€ 4.88
113	PRN	Nuova Grand Hotel	PRN1000-1	Nuova Grand Hotel	Dis	PRN1000	PRN1000	67.46	€ 220.00	15-09-16	31-12-24	€ 3.41	€ 6.50	€ 6.50	€ 6.50	€ 6.50	-91%	-91%	€ 1.09	€ 1.09	€ 1.09	€ 1.09
114	PRN	Nuova Grand Hotel	PRN1000-1	Nuova Grand Hotel	Dis	PRN1000	PRN1000	13.00	€ 220.00	15-09-16	31-12-24	€ 0.01	€ 0.20	€ 0.20	€ 0.18	€ 0.18	-91%	-91%	€ 2.00	€ 2.00	€ 2.00	€ 2.00

174



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-188/2

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregulloren nr.07-2023 për qiradhenien e aseteve të NSH, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën me 16 tetor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprobimet e kërkesës së Komunës së Gjilanit për mos rritje të lartësisë së qirasë sipas vendimit të BiD nr. Ref. BD-185/1 i datës 21 gusht 2023.
 - II. Ndryshohet pjesërisht vendimi i Bordit nr. Ref. BD-185/1 i datës 21 gusht 2023, për sa i përket asetit Çerdheja e fëmijëve "Integj", Gjilan dhe obligohet Autoriteti i Likuidimit të vazhdojë kontratën e qirasë me Drejtorinë e Arsimit KK Gjilan në shumën prej 500.00 €.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM


Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për ndryshim të pjesërishtëm të vendimit të Bordit të datës nr. Ref. BD-185/1 i datës 21 gusht 2023 sipas kërkesës së Komunës së Gjilanit të parashtruar me datë 25 shtator 2023.

Duke qenë se Agjencia është në proces të rivlerësimit të çmimit të të gjitha qirave, në grupin e II të qirave të rivlerësuar ka qenë edhe aset i NSH Integj në Gjilan që shfrytëzohet si qerdhe e fëmijëve. Komuna e Gjilanit njofton që me datë 18.09.2023 ka pranuar njoftim nga AKP drejtuar Drejtorisë së Arsimit lidhur me rritjen e vlerës së qirasë mujore nga 500€ në vlerë prej 4,262.99 €, dhe që kjo lartësi e qirasë është e papranueshme sepse në buxhetin e vitit 2023 Komuna nuk ka planifikuar këtë vlerë dhe se lartësia e qirasë e rivlerësuar paraqet problem serioz për arsyetimin e rritjes së çmimit afro 1000% në emër të qirasë. Komuna e Gjilanit poashtu ka njoftuar që ky aset është me interes publik për Komunën e Gjilanit dhe se kjo pronë është përfshirë edhe në planin urbanistik "Livadhet e Arapit" dhe sipas këtij plani kjo pronë është e dedikuar ekskluzivisht për Institucion Parashkollor.

Sipas vlerësimit të AL-së, kërkesa e Komunës së Gjilanit lidhur me rivlerësimin e bërë për objektin e Çerdhës së Fëmijëve NSH Integj në Gjilan, është arsyeshme meqë kemi të bëjmë me një institucion publik ku objekti është i dedikuar për qerdhe të fëmijëve. Poashtu sipas dispozitave ligjore të Rregullores së qirasë, ku thuhet se në rastet e qirave për institucionet publike, çmimi i qirasë do të përcaktohet nga Bordi i AKP-së duke marrë parasysh buxhetin e planifikuar nga institucioni publik kërkues për qiranë specifike". Duke marrë parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 16 tetor 2023.




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
ee.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-188/3

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregulloren nr.07-2023 për qiradhënien e aseteve të NSH, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën me 16 tetor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të hapësirës afariste në kuadër të ndërtesës administrative në rr. Fehmi Agani (te qafa), me sipërfaqe totale prej 275 m² në pronësi të NSH Mekanizimi PRN098, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 200.00 bruto në muaj për Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP).**

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas kërkesës së AQP për aset in e NSH Mekanizimi PRN098 në Prishtinë.

Aprovimin Me datë 04/10/2023 Agjencia Kosovare e Privatizimit, ka pranuar shkresën me nr. protokoli 3197, të parashtruar nga Përfaqësuesi i AQP-së, përmes së cilës kanë adresuar kërkesën për marrje me qira të kësaj hapësire të NSH Mekanizimi, për të realizuar akomodimin e zyrtarëve të AQP-së. Sipas vlerësimit të AL-së, kërkesa e AQP-së sa i përket çmimit është e ulët në krahasim me qiratë tjera në zonën përreth por meqë kemi të bëjmë me një institucion publik ku objekti është i dedikuar për interes public dhe kështu është në përputhje me dispozitat ligjore të Rregullores së qirasë, ku thuhet se në rastet e qirave për institucionet publike, çmimi i qirasë do të përcaktohet nga Bordi i AKP-së duke marrë parasysh buxhetin e planifikuar nga institucioni publik kërkuar për qiranë specifike". Në lidhje me këtë, më datë 04 tetor 2023 është pranuar shkresa nga ana e Përfaqësuesit të AQP-së, në të cilën kanë deklaruar se kanë të destinuar dhe limit buxhetor vetëm shumën prej 200.00 Euro në muaj (bruto). Arsyetimi se përse ky çmim është ofruar nga ana e AQP-së është cekur edhe në kërkesën e tyre, dhe kjo vjen si rrjedhojë e faktit që hapësira në të cilën kanë parashtruar kërkesë për të u vendosur ka nevojë për investime të mëdha për renovim në mënyrë që të krijohen kushte të duhura për akomodim të zyrtarëve të AQP-së. Sipas planifikimeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme (gjë të cilën e kanë deklaruar AQP në kërkesën e tyre) vlera e investimeve për renovim që parashihet arrin shumën prej 55,425.60 €. AQP ka deklaruar që fonde për investim në këto hapësira kanë vetëm 25,000.00 € dhe se për pjesën tjetër të fondeve edhe AQP pret të mbështetet nga ana e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Investimi i tillë në renovimin e kësaj hapësire natyrisht do të rriste vlerën e këtij objekti dhe poashtu do të ndikonte në mirëmbajtjen e tij.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 16 tetor 2023.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-188/4

Në bazë të neneve 6.2.1, 6.2.3 dhe 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe bazuar Rregulloren nr.06-2023 për Rregullat e tenderit si dhe Procedurat e shitjes me tender publik, pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit të AKP-së për aprovimin listës së aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore në Likuidim që do të publikohen për shitje si SHAL 64 me depozita, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën 16 tetor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprobimet lista e aseteve për shitje në SHAL 64 me gjithë depozitat e propozuara.

II. Listës nga SHAL 63 i largohen asetet i largohen asetet në vijim dhe ato shtohen në SHAL 64:

- Aseti nr. 25 - Bankkos Lokali në Deçan – NSH BANKKOS PRN 125
- Aseti nr. 26 - Ramiz Sadiku Toka në Obiliq, Ngastra kadastrale 1279/5 gjendet në ZK Obiliq, afër poligonit për gjuajtje Katana – NSH RAMIZ SADIKU PRN 035
- Aseti nr. 31 - Mulliri Lokali në Obiliq – NSH IMB MULLIRI PRN113

III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për aprovim të listës së aseteve për Shitje të Aseteve përmes Likuidimit SHAL 64. Poashtu duke qenë se ka pas kërkesa nga Komunitat për largim të aseteve nga SHAL 63 dhe SHAL 64, Bordin ka shqyrtuar të njëjtat dhe ka vendos që 3 prej atyre aseteve të largoj nga SHAL 63 dhe të vendos në SHAL 64 dhe të ju jap komunave edhe një afat optimal për të trajtuar procedurat/shkresat për shpronësim dhe nëse edhe pas afati deri në shpallje të SHAL 64 nuk ka njoftime nga Komunitat atëherë të njëjtat do të shpallen në shitje në SHAL 64.

Për kërkesën e Komunitat Istog për largim nga SHAL 64 të asetit nr.12 Bankkos Lokali në Istog NSH Bankkos PRN 125 Bordin u pajtua që ta largoj nga SHAL-i deri në sqarim të situatës së pronësisë.

Në bazë të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, AKP ka zotësi të plotë juridike, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj.

Në këtë kontekst një ndër detyrat themelore të Agjencisë është procesi i shitjes së pronave shoqërore në mbarë territorin e Kosovës. Ndër format e shitjeve që i përdorë Agjencia Kosovare e Privatizimit është shitja përmes tenderit publik dhe atë kryesisht nëpërmes grupimit të aseteve në Shitje të Aseteve përmes Likuidimit (SHAL). Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordin shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 16 tetor 2023.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400

Faks: +383 (0) 38 248 670

Email: info@pak-ks.org

www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

MIRATUAR NGA BORDI I DREJTORIVE NË Mbledhjen e Miratuar Nr. 28 Shtator 202

Numărul valabil: **SHALEA**
Data de expirare a dreptății și oportunității: **22 Martie 2023**

[illegible]

Kartë për përditësimin e shtetësive për shtet									
No	Regjion	Adresë	Adresë e shtetësisë	Titulli	Titulli i shtetësisë	Titulli i shtetësisë	Titulli i shtetësisë	Titulli i shtetësisë	Titulli i shtetësisë
1	Qyteti	QYT01	20	QYT01/20	Tërbë Cengës	Tërbë Cengës	Tërbë Cengës	Tërbë Cengës	Tërbë Cengës
2	Regjion	REG02	21	REG02/21	Regjion	Regjion	Regjion	Regjion	Regjion
3	Regjion	REG03	22	REG03/22	Regjion	Regjion	Regjion	Regjion	Regjion
4	Regjion	REG04	23	REG04/23	Regjion	Regjion	Regjion	Regjion	Regjion
5	Regjion	REG05	24	REG05/24	Regjion	Regjion	Regjion	Regjion	Regjion
6	Regjion	REG06	25	REG06/25	Regjion	Regjion	Regjion	Regjion	Regjion
7	Regjion	REG07	26	REG07/26	Regjion	Regjion	Regjion	Regjion	Regjion
8	Regjion	REG08	27	REG08/27	Regjion	Regjion	Regjion	Regjion	Regjion
9	Regjion	REG09	28	REG09/28	Regjion	Regjion	Regjion	Regjion	Regjion
10	Regjion	REG10	29	REG10/29	Regjion	Regjion	Regjion	Regjion	Regjion
11	Regjion	REG11	30	REG11/30	Regjion	Regjion	Regjion	Regjion	Regjion

三

Nr. Ref. BD-188/5

Në bazë të nenit 15.2.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 18 tetor 2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet azhurnimi/harmonizimi i akteve nënligjore në vijim me Rregulloren organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.
- II. Aprovohen:
 1. Statuti i Bordit;
 2. Rregullorja e Sekretarisë së Bordit;
 3. Procedurat bankare të fondeve në mirëbesim; dhe
 4. Rregullorja për investimet në letrat me vlerë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e Divizionit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve dhe Menaxhmentit për ndryshimin e pesë (4) akteve nënligjore sipas dispozitivit të këtij vendimi. Me hyrjen në fuqi të strukturës së re organizative dhe Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës u konsiderua e nevojshme që të azhurnohen përkatësisht të harmonizohen dhe të përshtatet terminologjia e përdorur në Statut të Bordit; Rregullore të Sekretarisë së Bordit; Procedura bankare të fondeve në mirëbesim; dhe Rregullore për investimet në letrat me vlerë - me strukturën e re organizative dhe Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, për mbarëvajtje të rregullt të proceseve të cilat janë rregulluar me këto akte nënligjore. Azhurnimet në këto akte nën ligjore janë të natyrës teknike dhe me qëllim të përshtatjes së terminologjisë së përdorur në strukturën e re organizative dhe Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Duke u bazuar në ato që u thanë më sipër, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 16 tetor 2023.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-188/6

Në bazë të nenit 15.2.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 18 tetor 2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet plotësim ndryshimi i tabelës 6.3 të Rregullores për Pagat e nëpunësve të AKP-së.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Divizionit të Burimeve Njerëzore për plotësim ndryshimi i tabelës 6.3 të Rregullores për Pagat e nëpunësve të AKP-së, e cila ka ardh si rrejdhojë e hyrjes në fuqi të strukturës së re organizative dhe Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës u konsiderua e nevojshme që të azhurnohet tabela 6.3 e Rregullores së Pagave, sikurse në vijim:

Ndryshimet janë si në vijim:

1. Pozita të reja:

- Drejtor i Departamentit të realizimit të aseteve dhe shpërndarjeve (nuk ka pasur zyrtarë në këtë pozitë);
- Udhëheqës i Divizionit të Sekretarisë Ekzekutive (nuk ka pasur zyrtarë në këtë pozitë);
- Udhëheqës i Shitjeve direkte (pozitë e cila më nuk I raporton Menaxhmentit por është në kuadër të Departamentit)

2. Janë shuar pozitat si në vijim:

- Drejtor i Shitjes (zyrtari në listë teprice);
- Drejtor i Marketingut, Marrëdhënieve me Publikun dhe Investitorët (zyrtari në listë teprice);
- Drejtor i Komisioneve Profesionale (zyrtari në listë teprice);
- Drejtor i Likuidimit (zyrtari merr shtesën tranzitore);
- Koordinator i Njesisë i Njesisë të Negocimit Direkt (zyrtari merr shtesën tranzitore)
- Koordinator i Njësive Ligjore dhe Kryesues i Opinioneve Ligjore dhe Shqyrtimit të Kontratave të Shitjes;
- Koordinator i Protokollimit, Arkivës e Shkresave Gjyqësore dhe Kryesues i Protokollimit (zyrtari merr shtesën tranzitore)
- Koordinator i Shërbimeve të Përgjithshme dhe Transportit dhe Kryesues i Transportit (zyrtari merr shtesën tranzitore);
- Udhëheqës i Sekretariatit të Komisioneve Profesionale (zyrtari merr shtesën tranzitore);
- Kryesues i Njesisë për trajtimin e aseteve jashtë vendit ka (zyrtari merr shtesën tranzitore);
- Kryesues i Protokollimit (zyrtari në listë teprice);
- Menaxher i Projektit të likuidimit/ Kryesues i Njesisë për zbatimin e projektit të likuidimit (zyrtari merr shtesën tranzitore);



- Kryesues i Njesisë së likuidimeve nga AKP (zyrtari merr shtesën tranzitore);
- Kryesues i Njesisë për Përgatitjen e Shitjes, Shqyrtimit Ligjor dhe Tenderimit (zyrtari merr shtesën tranzitore);
- Kryesues i Njesisë së Marketingut dhe marrëdhënie me investitorët (zyrtari merr shtesën tranzitore);
- Kryesues i Njesisë së Shkresave gjyqësore (zyrtari në listë tepricë);
- Kryesues i Njesisë për tranzicionin e Trepçës (zyrtari në listë tepricë);
- Kryesues i Njesisë për Marrëdhënie me Publikun (zyrtari në listë tepricë);
- Kryesues i Njesisë së Shitjes së Banesave;
- Zyrtar i Lartë për Bujqësi dhe Pylltari (zyrtari merr shtesën tranzitore)

3. Me ligjin për Pagat pozitat e mëposhtme janë të vendosura në kategori të veçanta:

- Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të brendshëm
- Auditorët
- Zyrtar i Kadastrit

4. Pozitat e mëposhtme janë riemëruar në Udhëheqës të Divizioneve:

- Drejtor i Burimeve Njerëzore;
- Drejtor i Prokurimit;
- Menaxherët e Zyrave Rajonale;
- Drejtor i Auditimit të brendshëm.


Gjithashtu pozita e Zyrtarit të Marketingut është vendosur edhe te grada-hapi 5-8 si dhe 5-4 pasi që ka zyrtarë të cilët marrin shtesën tranzitore sipas Ligjit për Pagat;

Gradat-hapat dhe pagat respektive nuk ndryshojnë pasi që sipas nenit 41 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, zyrtarët e AKP-së përfitojnë shtesën tranzitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë.

Duke u bazuar në ato që u thanë më sipër, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 16 tetor 2023.




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr. Ref. BD-188/7

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 16 tetor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet iniciimi i procedurës për shitje me negociim direkt për privatizimin të sipërfaqes tokësore 1270m2, pjesë e parcelës Nr. 491-8, me sipërfaqe të përgjithshme 2389 m2, pronë e të NSH Mirusha, Zona Kadastrale Malishevë, Komuna Malishevë me parashtruesin nga Malisheva.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për shitje direkte, në të cilin rekomandohet aprovimi i iniciimit të procedurës për shitje me negociim direkt për sipërfaqen tokësore 1270m2, pjesë e parcelës Nr. 491-8, me sipërfaqe të përgjithshme 2389 m2, pronë e të NSH Mirusha, Zona Kadastrale Malishevë, Komuna Malishevë me parashtruesin nga Malisheva. Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, dhe duke qenë se rasti plotëson kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 3.1.2 të Rregullores Nr. 06/2022, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 16 tetor 2023.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr. Ref. BD-188/8

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 16 tetor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet Inicimi i procedurës për shitje me negociim direkt, të ngastrës kadastrale 5-75 ZK Dollovë, Komuna e Klinës, me sipërfaqe prej 2786 m², pronë e ndërmarrjes shoqërore "Kombinati Bujqësor Industrial" Pejë, me parashtruesin , Dollovë i përfaqësuar nga
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për shitje direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për inicim të procedurës për shitje me negociim direkt për parcelën kadastrale 5-75 ZK Dollovë, komuna e Klinës, me sipërfaqe prej 2786 m², pronë e ndërmarrjes shoqërore "Kombinati Bujqësor Industrial" Pejë, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shqërore.

